REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE, SHKURT 2025

Nr. Rendor	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundimit të kërkesës	Tarifa
1	30.1.2025	Kërkohet informacion lidhur me programet e transparencës së ministrave të shtetit si dhe lidhur me konsultimet publike të mbajtura në kuadër të miratimit të strategjisë kundër korrupsionit përgjatë vitit 2024.	5.2.2025	1. Bazuar në ligjin nr. 9000, datë 30.1.2003 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", neni 3, përcakton se: "1. Kryeministria është person juridik, publik, që mbështet veprimtarinë e Këshillit të Ministrave, të Kryeministrit, të Zëvendëskryeministrit dhe të Ministrit të Shtetit", ndërsa sipas nenit 4, "Kryeministria përfshin: aparatin e Këshillit të Ministrave, kabinetin e Kryeministrit, kabinetin e Zëvendëskryeministrit dhe kabinetin e Ministrit të Shtetit. Pra, ministrat e shtetit së bashku me kabinetet përkatëse janë pjesë e strukturës dhe organikës së Kryeministrisë. 2. Të gjitha pyetjeve tuaja lidhur me procesin e konsultimit publik të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024-2030, Planit të Veprimit 2024-2026 në zbatim të saj dhe Pasaportës së Treguesve të Performancës", iu përgjigjet raporti individual i konsultimit publik, i publikuar në Regjistrin Elektronik të Njoftimeve dhe Konsultimeve Publike, në linkun e mëposhtëm: file:///C:/Users/merita.bundo/Doënloads/RENJK_765_Raport-i-Konsultimit-Publik_SNKK-2030.pdf	Përfunduar	Nuk ka
2	1.2.2025	Kërkohet informacion lidhur me një anketë të zhvilluar me prindrit për mundësine e mbylljes së Tik Tok.	5.2.2025	Deleguar Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, referuar nenit 12, pika 2, të ligjit nr 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar.	Deleguar	Nuk ka
3	10.2.2025	Kërkoj një informacion lidhur me vendimin 401, të datës 19 dhjetor 2023 për lirimin e pronës. Më konkretisht bëhet fjalë për çështjen e ekzekutimit të vendimit gjyqësor për dorëzimin e truallit. Kjo çështje përfshin disa aspekte ligjore dhe administrative që lidhen me ekzekutimin e një vendimi gjyqësor për dorëzimin e një trualli, ekzistencën e ndërtimeve të përkohshme pa leje, kundërshtimin e veprimeve përmbarimore dhe vlefshmërinë e një kontrate qiraje afatgjatë me shtetin shqiptar.	12.2.2025	Informohet se ligji 119/2014 "Për të drejtën e informimit" rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike, por nuk sanksionon detyrim të autoritetit publik për të përgatitur analiza, informacione, për t'ju përgjigjur pyetjeve, për të dhënë sqarime etj. Sa më sipër, bazuar në nenin 3, pika 3 e ligjit 119/2014 "Për të drejtën e informimit", ku përcaktohet se: "Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentit", kërkesa duhet të saktësojë dokumentin zyrtar që nevojitet.	Përfunduar	Nuk ka
4	18.2.2025	Kërkohet info për strukturën e ministrave të shtetit:1- Organigrama e drejtorisë/zyrës së komunikimit. 2- Numri i punonjësve me kontratë të plotë për komunikimin dhe pozicionin përkatës (p.sh.: Specialist për media /specialist për faqen e internetit / kameraman fotograf etj.). 3- Numri i punonjësve me kontratë të përkohshme për sektorin e komunikimit dhe pozicionin përkatës. 4- Fondi vjetor i alokuar për këtë sektor për vitet 2022, 2023, 2024, 2025 dhe mënyra e shpërndarjes së tij (p.sh.: Fondi i pagave, fondi për aktivitete publike etj.) 5- Sa ka ndryshuar numri i punonjësve për Drejtorinë/zyrën e komunikimit për vitet 2021, 2022, 2023, 2024, 2025.	23.2.2025	Informohet se ligji 119/2014 "Për të drejtën e informimit" rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike, por nuk sanksionon detyrim të autoritetit publik për të përgatitur analiza, për të dhënë sqarime, për t'ju përgjigjur pyetjeve etj. Gjithashtu dëshiroj t'ju informoj se bazuar në ligjin nr. 9000, datë 30.1.2003 "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", neni 3, përcakton se: "1. Kryeministria është person juridik, publik, që mbështet veprimtarinë e Këshillit të Ministrave, të Kryeministrit, të Zëvendëskryeministrit dhe të Ministrit të Shtetit", ndërsa sipas nenit 4, "Kryeministria përfshin: aparatin e Këshillit të Ministrave, kabinetin e Kryeministrit, kabinetin e Zëvendëskryeministrit dhe kabinetin e Ministrit të Shtetit. Pra, ministrat e shtetit së bashku me kabinetet përkatëse janë pjesë e strukturës dhe organikës së Kryeministrisë, ndërsa buxhetet vjetore të tyre janë pjesë përbërëse e buxhetit të Kryeministrisë dhe gjenden në ligjin për buxhetin e shtetit, sipas viteve respektive. Sa më sipër, bazuar në nenin 3, pika 3 e ligjit 119/2014 "Për të drejtën e informimit", ku përcaktohet se: "Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentit", lutem gjeni bashkëlidhur linkun në të cilin është publikuar organigrama e Kryeministrisë, ku përfshihen kabinetet e ministrave të shtetit: https://ëëë.kryeministria.al/ëp-content/uploads/2024/11/Organika-e-Kryeministrise.pdf	Përfunduar	Nuk ka
5	18.2.2025	Kërkohet informacion për marrjen e pensionit të posaçëm.	19.2.2025	Këshilli i Ministrave është i detyruar të respektojë fondin përkatës të planifikuar për pensionet e posaçme dhe nuk mund të miratojë më tepër se 15 pensione në vit, prandaj gjendet në vështirësi për të plotësuar çdo kërkesë dhe propozim që i paraqitet për miratim. Sikundër është praktikë e ndjekur tashmë prej vitesh, në fund të çdo viti kalendarik, praktikat dhe propozimet të cilat janë vlerësuar nga Komisioni se plotësojnë kriteret ligjore, nëpërmjet një vendimmarrje kolegjiale, kalojnë për miratim në mbledhjen e Këshillit të Ministrave. Duke vlerësuar kontributin dhe meritat tuaja në fushën e sportit, Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për dhënien e pensioneve të posaçme shtetërore dhe të shtesave të pensioneve të posaçme shtetërore, do të rimarrë në shqyrtim kërkesën e paraqitur pranë Komisionit, propozim i cili mbetet i vlefshëm për t'u rivlerësuar, së bashku me një numër të konsiderueshëm të kandidatëve të propozuar në vite".	Përfunduar	Nuk ka
6	21.2.2025	Kërkohet informacion rreth VKM 843, dt. 26.12.2024 "Percaktimin e kritereve, dokumentacionit dhe procedurave per mbledhjen e te dhenave per identifikimin e personave qe u perkasin pakicave kombetare". - Pasqyrimi ne listen perkatese te pakicave kombetare percaktohet brenda 30 diteve. Si do veprohet ne rastet kur per perfitimin e nje sherbimi te caktuar p.sh perjashtimi i femijeve nga pagesa e tarifes se regjistrimit ne kopshte ka afat per dorezimin e dokumentacionit 1 jave? - Per sa kohe eshte vlefshmeria e vertetimit te marre nga komisioni? - Si do te veprohet per plotesimin e formularit per personat te cilet nuk dine te shkruajne? - Jeni te lutur te na vini ne dispozicion nje kopje te formularit qe duhet plotesuar per vetidentifikimin.	22.2.2025	Informohet se ligji 119/2014 "Për të drejtën e informimit" rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike, por nuk sanksionon detyrim të autoritetit publik për të përgatitur analiza, për t'ju përgjigjur pyetjeve, për të dhënë sqarime etj. Sa më sipër, bazuar në nenin 3, pika 3 e ligjit 119/2014 "Për të drejtën e informimit", ku përcaktohet se: "Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentit", dërgohet vendimi nr. 843, datë 26.12.2024 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kritereve, dokumentacionit dhe procedurave për mbledhjen e të dhënave për identifikimin e personave që u përkasin pakicave kombëtare", si dhe formularin që duhet plotësuar për vetidentifikimin.	Përfunduar	Nuk ka
7	24.2.2025	Kërkohet informacionsi më poshtë: 1. A është ende në plan mbyllja e platformës TikTok në Shqipëri? 2. Nëse po, cili është afati i parashikuar për këtë veprim? 3. A janë ndërmarrë hapa konkretë deri më tani për zbatimin e këtij vendimi? 4. Nëse procesi është pezulluar, cilat janë arsyet e këtij ndryshimi? 5. Cili institucion do të jetë përgjegjës për monitorimin dhe zbatimin e kësaj mase?	25.2.2025	Deleguar Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve referuar nenit 12, pika 2, të ligjit nr 119/2014 "Për të drejtën e informimit", i ndryshuar.	Deleguar	Nuk ka